



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

---

Numri i lëndës: 2022:008632

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05638988

**P.nr.164/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale ndaj të pandehurit F.B., për shkak të veprës penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 paragrafi 2 në lidhje me paragrafin 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.73/2022 të datës 13.09.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 29.04.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Arjan Xhema, i pandehuri F.B. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat Shyqyri Sylja, me datë 29.04.2024 e shpalli publikisht, ndërsa me datë 30.04.2024 e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

F.B., nga i ati R., e ëma E., e vajzërisë V. i lindur me datë ... në Skenderaj, me vendbanim në fshatin Klladernicë, lagje T..., me vendqëndrim të përkohshëm në Gjermani, ... R... F..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i një (1) fëmije, punon në ndërtimtari në firmën “G. B”, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Nga data e pavërtetuar deri me datën 09.12.2021 në Skenderaj, me vetëdije ka përdorur automjetin motorik të llojit “VW Golf 3”, me ngjyrë të kuqe, viti i prodhimit ..., numri i regjistrimit ..., me numër të shasisë WVWZZZ1HZSB..... ku pas përfundimit të kontrollimit nga ana e “Euro Lab” në Fushë Kosovë, gjatë kontrollimit teknik të veturës së lartcekur është vërtetuar se në shasinë e cekur janë vërejtur gjurmët e saldimit, gjegjësisht numri i shasisë së lartcekur nuk i përket automjetit të cekur gjë e cila vërtetohet edhe me konstatimin e Agjencisë Kosovare të Forenzikës, të datës 23.02.2022.

**Me këtë ka kryer veprën penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 390 të KPRK-së dhe nenit 242, 270, 364, 449, 450, dhe 452 të KPP-së e:

## G J Y K O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 500.00 (*me fjalë: pesëqind*) euro, të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- II. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej pesë (5) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- III. Në mbështetje të nenit 270 paragrafi 1 të KPP-së, URDHËROHET të konfiskohet: Automjeti “VW Golf 3”, me ngjyrë të kuqe, viti i prodhimit ..., me regjistrim Nr. ..., me numër të shasisë WWZZZ1HSB..., si dhe Certifikata për regjistrimin e automjetit me numër CRA - ....
- IV. Urdhërohet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar që sendet e konfiskuara sipas pikës III të këtij Aktgjykimi, t'i administroj sipas procedurave ligjore, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- V. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- VI. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr 73/2022 të datës 13.09.2022, kundër të pandehurit F.B., për shkak të veprës penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata për këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 29.04.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Arjan Xhema, i pandehuri F.B. dhe mbrojtësi i tij, avokat Shyqyri Sylja, sipas detyrës zyrtare.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjenë veten fajtor për veprën penale, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimit të fajësisë,

pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë. Tutje, ka premtuar se më nuk do të bie ndesh me ligjin, ka ndërtuar jetë të re në Gjermani, dhe e ka lutur gjykatën që t'i shqiptoj një dënim më të butë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat lëndës, ndërsa sa i përket sanksionit penal i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor, duke u marr parasysht të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Mbrojtësi i të pandehurit F.B., avokat Shyqyri Sylja, ka deklaruar se pas pranimit të fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij i cili pranim është bërë pa kurrfarë presioni, ndikimi dhe pas konsultimit me të si mbrojtës, i ka propozuar gjykatës të aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit të ketë parasysht një mori rrethana lehtësuese si: është i moshës relativisht të re, i martuar, baba i një fëmije, më parë i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë penale për ndonjë vepër tjetër penale, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, pranimin e fajësisë, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale, mbajtës i familjes dhe në mungesë të rrethanave rënduese i ka propozuar gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më i butë, një dënim me gjobë me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit dhe i njëjti të vazhdoj punën e tij në Gjermani atje ku është duke punuar.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të njëjtin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit, me numër të referencës 2022-BI-02, i datës 13.01.2022; Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin F.B., i datës 13.01.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e automjetit, i datës 13.01.2022; Raporti i shpejtë, i datës 09.12.2021; Raporti dhe fotografitë e kontrollit teknik të automjetit nga "Euro Lab"; Konstatimi i Agjencisë Kosovare të Forenzikës Nr. AKF/2022-0203/..., i datës 23.02.2022, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i 'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Rrethana rënduese në këtë rast, gjykata nuk ka gjetur. Ndërsa si rrethana lehtësuese, gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehë keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, i njëjti i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëris më vepra të tilla apo të ngjashme penale, rrethanat personale pasi që i njëjti është i martuar, baba i një fëmije dhe se i njëjti tashmë ka ndërtuar jetë të re në botën e jashtme.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë dhe me dënim me burgim me kusht ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen të pandehurit të përmbahen nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Gjykata, si në dispozitiv të aktgjykimit, ka urdhëruar konfiskimin e sendit, respektivisht Automjetin “VW Golf 3”, me ngjyrë të kuqe, viti i prodhimit ..., regj. Nr. ...., me numër të shasisë WWZZZ1HSB..., si dhe Certifikatën për regjistrimin e automjetit – CRA- ...., të cilat janë sende janë mjet i kryerjes së veprës penale siç vërtetohet më lartë, kjo në mbështetje të nenit 270 paragrafi 1 KPP-së, e cila dispozitë përcakton se: *“1. Para se gjykata të mund të urdhërojë konfiskimin e pasurisë që ishte mjet, prokurori i shtetit e provon në shqyrtimin kryesor se pasuria ishte mjet i veprës penale për të cilën i pandehuri është dënuar.”*. Se çka nënkuptojmë me mjet të veprës penale, është përcaktuar në nenin 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.38 pika 1.38.4, e cila dispozitë përcakton se: *“1.38.4. Pasuritë, në tërësi apo pjesërisht, të nevojshme për të lehtësuar ndonjë veprim në mbështetje të veprës penale.”*.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 242, 270, 364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA SKENDERAJ**  
**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr.164/2022, datë 30.04.2024**

Zyrtarja ligjore  
Doruntina BEKA

Gjyqtari  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.